



COVID-19 dhe leja e paguar shëndetësore

Punonjësit që kanë COVID-19 ose kanë qenë në kontakt me dikë me COVID-19 mund të marrin leje shëndetësore (leje nga puna) pavarësisht nga statusi i imigrimit. Ligjet e shtetit dhe ato lokale lejojnë që punonjësit të marrin leje nga puna për t'u kujdesur për veten e tyre ose një anëtar të familjes. Për shembull, punonjësit mund të marrin leje nga puna për të kryer karantinën* ose për t'u izoluar, ose nëse mbyllet shkolla apo kopshti i fëmijës së tyre. Punëdhënësve nuk u lejohej të keqtrajtojnë apo ndëshkojnë punonjësit për shkak të përdorimit apo të kërkesës për leje shëndetësore. Kjo fletë ka një përmbledhje të të gjitha ligjeve.

Shënim: Ndonëse një ligj federal ka skaduar më 31 dhjetor 2020, punonjësit mund të jenë në gjendje të kërkojnë përfitime federale për lejet shëndetësore të përdorura në 2020.

*Të jesh në karantinë do të thotë të qëndrosh larg të gjithëve për 10 ditë për të parandaluar përhapjen e COVID-19.

SHTETI

Ligji i emergjencës për leje të paguar shëndetësore për shkak të COVID-19 i shtetit të Nju-Jorkut

Kush mbulohet	Çfarë mbulohet	Koha e mbulimit
<p>Të gjithë punonjësit e sektorit publik dhe privat që kanë marrë urdhër të hyjnë në karantinë. Punonjësit duhet t'i telefonojnë nr. 855-491-2667 për të marrë urdhër-karantinim.</p> <p>Punonjësit që mund të marrin përfitime federale sipas ligjit për reagimin ndaj koronavirusit me përparësi për familjet (Families First Coronavirus Response Act, FFCRA) (shih seksionin federal) duhet t'i përdorin të parat dhe mund të përdorin përfitime shtetërore vetëm nëse ligji i shtetit parashikon më shumë përfitime sesa FFCRA.</p> <p>Punonjësit <i>nuk mbulohej</i> nëse kanë vizituar një zonë të përfshirë në komunikatën e udhëtimit të shtetit të Nju-Jorkut për udhëtim personal.</p>	<p>Leja e paguar shëndetësore mbulohet për punonjësit që kanë marrë urdhër karantinimi. Për shembull, ata:</p> <ul style="list-style-type: none"> kanë simptoma të COVID-19; ose kanë qenë në kontakt të ngushtë me dikë me COVID-19. 	<p>Në varësi të madhësisë dhe/apo të ardhurave të punëdhënësit, punonjësit mund të marrin midis 5 deri 14 ditë të paguara nga punëdhënësi.</p> <p>Shënim: Punonjësit mund të përdorin edhe përfitimet e lejes së paguar familjare apo të invaliditetit për ditët e karantinës që nuk paguhen nga punëdhënësi.</p> <p>Leja e paguar shëndetësore sipas ligjit të shtetit vepron përveç lejes së mbledhur shëndetësore sipas ligjit të qytetit.</p>

? Kontaktoni me Departamentin e Punës të shtetit të Nju-Jorkut: Telefonojini nr. **844-337-6303** | Vizitoni paidfamilyleave.ny.gov/covid19

Leje e paguar nga shteti i Nju-Jorkut për vaksinimet kundër COVID-19

Ky ligj është në fuqi nga 12.3.2021 deri më 31.12.2022.

Kush mbulohet	Çfarë mbulohet	Koha e mbulimit
<p>Të gjithë punonjësit e sektorit publik dhe privat në shtetin e Nju-Jorkut, pavarësisht madhësisë së punëdhënësit.</p>	<p>Leja e paguar shëndetësore mbulohet për punonjësit që:</p> <ul style="list-style-type: none"> kryejnë një vaksinë me injeksion kundër COVID-19 nëse kërkohet nga vaksina; ose kryejnë dy vaksina me injeksion kundër COVID-19 nëse kërkohet nga vaksina 	<p>Punonjësit përfitojnë deri në 4 orë për injeksion vaksine, për një total prej 8 orësh.</p> <p>Shënim: Leja e paguar për vaksinime kundër COVID-19 jepet si shtesë mbi lejen e akumuluar sipas ligjeve të shtetit apo të qytetit për lejet e paguara shëndetësore. Punonjësit mund ta përdorin lejen e akumuluar për t'u shëruar nga efektet anësore të vaksinës kundër COVID-19.</p>

? Kontaktoni me Departamentin e Punës të shtetit të Nju-Jorkut: Telefononi në nr. **888-469-7365** | Vizitoni dol.ny.gov dhe kërkon "paid leave for COVID vaccine" (leje e paguar për vaksinën kundër COVID-19)

Ligjet lokale dhe federale >>

LOKALE

Ligji për leje të paguar shëndetësore sigurie i qytetit të Nju-Jorkut

Kush mbulohet	Çfarë mbulohet	Koha e mbulimit
Të gjithë punonjësit në banesa (në shtëpi) dhe punonjësit në biznese të çfarëdo madhësie apo OJF në qytetin e Nju-Jorkut (duke përfshirë punonjësit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të përkohshëm).	Leja shëndetësore mbulohet për të gjithë punonjësit që: <ul style="list-style-type: none">janë të sëmurë;kanë nevojë për kujdes parandalues;kanë për detyrë të qëndrojnë në karantinë;kërkojnë diagnostikim apo trajtim për një sëmundje, lëndim apo problem shëndetësor; oseduhet të kujdesen për një familjar për arsyet e mësipërme. Leja shëndetësore është e paguar për të gjithë punonjësit në banesa dhe punonjësit jo në banesa nëse punëdhënësi ka 5 a më shumë punonjës. Leja shëndetësore është e papaguar për punonjësit jo në banesa nëse punëdhënësi ka më pak se 5 punonjës dhe të ardhura neto më pak se 1 milion dollarë.	Varet nga madhësia e punëdhënësit: <ul style="list-style-type: none">(100+ punonjës) Punonjësit mund të përfitojnë <i>deri në 56 orë</i> leje shëndetësore në vit.(1-99 punonjës) Punonjësit mund të përfitojnë <i>deri në 40 orë</i> leje shëndetësore në vit. Shënim: Të gjithë punonjësit përfitojnë 1 orë leje shëndetësore për çdo 30 orë pune.

? Kontaktoni me Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Punonjësve të qytetit të Nju-Jorkut:

Telefonojini **311** dhe thoni "Paid Safe and Sick Leave" (leje e paguar për raste nevojë dhe shëndetësore) |

Vizitoni nyc.gov/workers | Email OLPS@dca.nyc.gov

Punëdhënësit mund vetëm të bisedojnë nga interneti në adresën nyc.gov/BusinessToolbox.

FEDERALE

Leja e paguar e shëndetësore sipas ligjit të reagimit ndaj koronavirusit COVID-19 (FFCRA)

Ligji federal ka qenë në fuqi nga 2.4.2020 deri më 31.12.2020. Punonjësit mund të kenë mundësinë të kërkojnë përfitime federale për lejet e shëndetësore të përdorura gjatë kësaj periudhe.

Kush mbulohet	Çfarë mbulohet	Koha e mbulimit
Punonjësit e sektorit privat dhe publik nëse punëdhënësi ka 500 a më pak punonjës (duke përfshirë punonjësit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme). Punonjësit mund të mos mbulohen nëse: <ul style="list-style-type: none">janë personel shëndetësor apo të ndihmës së shpejtë; osepunëdhënësi i tyre ka 50 a më pak punonjës dhe përballet me vështirësi financiare.	Leja e paguar shëndetësore mbulohet për punonjësit që: <ul style="list-style-type: none">janë urdhëruar të kryejnë karantinë ose janë duke u kujdesur për një familjar i cili është urdhëruar të kryejë karantinë;kryejnë karantinë sepse ua ka këshilluar mjeku;kanë shfaqur simptomat e COVID-19 dhe kërkojnë të diagnostikohen;janë diagnostikuar me një problem shëndetësor në lidhje me COVID-19; osekanë fëmijë, kopshti apo shkollë e të cilëve është mbyllur për shkak të COVID-19.	Varet nga statusi i punës: <ul style="list-style-type: none">Punonjësit me kohë të plotë mund të përdorin <i>deri në 80 orë pune</i>.Punonjësit me kohë të pjesshme mund të përdorin numrin mesatar të orëve që punojnë në një periudhë dyjavore. Shënim: Punonjësit mund të përfitojnë të drejtën e lejes së zgjeruar të paguar ose të papaguar sipas ligjit për lejen familjare dhe mjekësore (Family and Medical Leave Act, FMLA).

? Kontaktoni me Departamentin e Punës së SHBA-së: Telefoni në nr. **866-487-9243** | Vizitoni dol.gov/agencies/whd/pandemic